




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Kujtesa Net
Fiton Peja
Drejtore
Prishtinë



VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2021/309- Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për
Kujtesa Net (Palë përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datën 4 nëntor 2020 ka miratuar Rregulloren KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, qëllimi i së cilës është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM me datën 1 shtator 2021 ka pranuar një Ankesë nga Corint Media GmbH (ish VG Media GmbH) ndaj Palës përgjegjëse, me pretendimin se ky operator është duke i ritransmetuar pa marrëveshje valide kanalet Pro Siben, Pro Sieben Maxx, Sat.1 dhe Sat.1 Gold.
3. KPM me datën 13 tetor 2021 i ka dërguar një shkresë Palës përgjegjëse përmes të cilës ka kërkuar që të deponojë konfirmimet/autorizimet nga dhënësi i të drejtave për ritransmetimin e këtyre kanaleve në territorin e Kosovës.
4. Pala përgjegjëse nuk ka ofruar përgjigje brenda afatit të paraparë me kërkesën që KPM i ka dërguar lidhur me Ankesën në fjalë.
5. KPM, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës përgjegjëse me Rregulloren KPM-2020/01 ka realizuar një monitorim dhe bazuar në Raportin e monitorimit të datës 27 tetor 2021 ka gjetur se në katalogun e kanaleve të Palës përgjegjëse ritransmetohen kanalet: Pro Siben, Pro Sieben Maxx, Sat.1 dhe Sat.1 Gold.
6. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 9 nëntor 2021 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe e ka udhëzuar që menjëherë pas pranimit të kësaj letre, t'i largojë nga ritransmetimi kanalet Pro

Siben, Pro Sieben Maxx, Sat.1 dhe Sat.1 Gold deri në sigurimin e të drejtave të transmetimit.

7. KPM me datën 25 nëntor 2021 ka pranuar nga Pala përgjegjëse një marrëveshje (me afat deri në vitin 2019, me mundësi vazhdimi për nga një vit kalendarik deri në njoftim me shkrim për shkëputje të saj nga ana e VG Media GmbH), mirëpo pas vlerësimit ligjor dhe duke u bazuar në njoftimin e dhënësit të të drejtave (Corint Media GmbH) se marrëveshja me Palën përgjegjëse është ndërprerë, KPM ka gjetur se Pala përgjegjëse është duke i ritransmetuar pa marrëveshje valide kanalet Pro Sieben, Pro Sieben Maxx, Sat 1, dhe Sat 1 Gold.
8. KPM për të verifikuar sërish pajtueshmërinë e Palës përgjegjëse me Rregulloren KPM-2020/01, ka monitoruar edhe një herë këtë operator dhe bazuar në Raportin e monitorimit të datës 26 nëntor 2021 ka gjetur se Pala përgjegjëse ka larguar nga ritransmetimi Pro Sieben Maxx dhe Sat 1 Gold, ndërsa është duke vazhduar t'i ritransmetojë kanalet Pro Sieben dhe Sat 1 pa të drejtë transmetimi, duke vepruar kështu në kundërshtim me Rregulloren KPM-2020/01.

Analiza ligjore

9. Komisioni i Pavarur i Mediave, bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala përgjegjëse bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2020/01.

Neni 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimit medial bazuar vetëm në marrëveshje valide për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.”

10. KPM bazuar në Raportet e monitorimit konstaton se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2020/01, duke ritransmetuar pa marrëveshje valide kanalet: Pro Sieben dhe Sat 1.
11. Komisioni duke u bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2020/01.


Vendim

12. Pala përgjegjëse urdhërohet që menjëherë të ndërpresë ritransmetimin e kanaleve: Pro Sieben dhe Sat 1;
13. Pala përgjegjëse sanksionohet me masë sanksionuese Vërejtje në bazë të nenit 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së;
14. Në rast se Pala përgjegjëse, edhe pas pranimit të Vendimit, nuk i heq nga ritransmetimi kanalet: Pro Sieben dhe Sat 1, ashtu siç përcaktohet me Rregulloren KPM-2020/01,

Komisioni do të ndërmarrë masa tjera sanksionuese ndaj Palës përgjegjëse, në pajtueshmëri me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

E drejta për ankesë

15. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
16. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat Latifi

Kryetar



21.12.2021
Datë